

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Serafimovski: Projektligji për tregjet bujqësore synon t'u japë bujqve më shumë siguri për shitjen e prodhi meve
ADRESA	https://albeu.com/maqedoni/serafimovski-projektligji-per-tregjet-bujqesore-synon-tu-jape-bujqve-me-shume-siguri-per-shitjen-e-prodhimeve/1027681/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 18:25:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 18:24:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	418c8b01ce2883ff87c3e545b6a020fb3fa060d598f9f5f45cab644d1de0a047
TEKSTI	0634ab8949e4fa7fbd4cfefe7f8847ea8df0206e917426dc71590db8fe356d23
PAMJA	f3fe000e563e61059eafda873d16f0ff8c610346677ab471eec7960d41e1fda9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e18b9c78509165b9909cca131ffa549e94c50924f270faf39345e58bf1432738
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b795f32e8dcdad3401c122ecb35fb566e35fee7f00b27116f873c51e2a9a0ff8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e18b9c78509165b9909cca131ffa549e94c50924f270faf39345e58bf1432738>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Serafimovski: Projektligji për tregjet bujqësore synon t'u japë bujqve më shumë siguri për shitjen e prodhimeve



Përgjegjësitë mes prodhuesve, blerësve dhe përpunuesve do të ndahen më qartë, ndërsa bujqit do të kenë më shumë siguri për shitjen e produkteve të tyre. Kështu deklaroi ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Borçe Serafimovski, gjatë debatit publik për Projektligjin e ri për rregullimin e tregjeve me produkte bujqësore, të mbajtur në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Para përfaqësuesve të shoqatave bujqësore, kooperativave, prodhuesve, blerësve, përpunuesve, odave ekonomike, si dhe institucioneve shkencore e profesionale, Serafimovski tha se bujqësia nuk mund të mbështetet më të zgjidhjet e imponuara dhe të çastit. Sipas tij, synimi është ngritja e një sistemi që zbulon herët rreziqet, vendos rregull në tregje dhe pakëson pasigurinë e prodhuesve. Ai theksoi se bujku nuk duhet të përballojë i vetëm rrezikun e prodhimit e të mësojë kushtet e shitjes vetëm pasi ka mbledhur produktin, kur mundësitë e zgjedhjes janë kufizuar.

Ministri shpjegoi se projektligji i trajton si pjesë të një sistemi të vetëm blerjen e organizuar, marrëdhëniet kontraktuale, informacionin për tregun, masat e ndërhyrjes gjatë çrregullimeve serioze, organizimin e prodhuesve, skemat shkollore, promovimin e produkteve maqedonase dhe standardet e tregut. Ai sqaroi se nuk parashikohet caktim administrativ i çmimeve të blerjes. Në vend të tij, propozohen rregulla të qarta, më shumë transparencë dhe mekanizma që institucionet të veprojnë në kohë.

Sipas Serafimovskit, marrëveshjet duhet të respektohen, produktet e dorëzuara të maten e të klasifikohen drejt dhe pagesat për bujqit të kryhen brenda afatit të caktuar. Kontrata me shkrim do të nënshkruhet përpara dorëzimit dhe do të përcaktojë paraprakisht sasinë, cilësinë, çmimin ose mënyrën e përlogaritjes së tij, afatin e pagesës dhe shpenzimet përkatëse. Rregullat do të zbatohen njësoj për të gjithë dhe shkelja e tyre do të sjellë përgjegjësi, theksoi ai.

Gjurmueshmëria dhe kontrolli i blerjes së organizuar do të përmirësohen përmes evidencës elektronike dhe të dhënave publike për blerësit e regjistruar, sqaroi ministri. Sistemi informativ i tregut bujqësor dhe observatori kombëtar do të ofrojnë të dhëna mbi prodhimin, ofertën, kërkesën, rezervat, çmimet, importin dhe eksportin. Kjo, sipas tij, do t'u mundësojë institucioneve të dallojnë më herët rreziqet dhe t'i orientojnë më saktë politikat bujqësore.

të fundit /



Serafimovski:
Projektligji për tregjet bujqësore synon t'u...



Muriqi renditet i katërti
mes golashënuesve historikë të Ligës së...



Nga Bruno Fernandes te Vitinha:
Sofascore bashkon elitat e futbo...



Manchester City përballet me
mundësinë e dënime...



Këshilli Ministror për Integrim Evropian
shqyrton zbatimin e...



Protestuesit ndryshojnë kërkesën ndaj Ramës:
"Arrestoni Ramën", jo...



Rama në OKB:
Shqipëria e ka përjetuar të ardhmen që bota...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Serafimovski tha se synimi është të planifikohet përpara se produktet të mbeten pa treg dhe që prodhimi të përafrohet gradualisht me kërkesën reale e potenciale, brenda kushteve të tregut. Ai shtoi se ekonomia e tregut nuk mund të përdoret si arsye për mungesë transparence, ndryshim të njëanshëm të kushteve apo kalim të gjithë barrës te prodhuesi.

Një pjesë e rëndësishme e projektligjit u kushtohet organizatave dhe grupeve të prodhuesve, shoqatave të tyre, programeve operative dhe mundësive për mbështetje financiare. Ministri vlerësoi se planifikimi i përbashkët, standardizimi i cilësisë, përqendrimi i ofertës dhe dalja e organizuar në treg do të rrisin fuqinë negociuese të bujqve dhe mundësinë e tyre për të arritur te blerësit më të mëdhenj. Sipas tij, një bujk është më i fortë kur nuk del i vetëm në treg; për këtë arsye po krijohen kushte që prodhuesit të bashkëpunojnë, të planifikojnë së bashku dhe të ofrojnë sasi më të mëdha, cilësi të njëtrajtshme e një pozicion më të fortë në negociata.

Propozimi përfshin gjithashtu instrumente për ndërhyrje publike dhe mbështetje të magazinimit privat kur tregu përballet me çrregullime serioze ose rrezik të menjëhershëm. Serafimovski tha se projektligji harmonizohet me rregullat e Bashkimit Evropian për organizimin e përbashkët të tregjeve bujqësore, duke i kushtuar vëmendje zbatimit praktik nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, shërbimet inspektuese dhe subjektet ekonomike.

Shtuar më 25.09.2026 20:24

Tags: [Borçe serafimovski](#), [Bujqit e maqedonisë](#), [Ministria e bujqësisë pylltarisë dhe ujërave maqedoni](#)



Klekovski: Ka përfunduar regjistrimi për 300 specialistantët, vendet e...



Shkupi ashpëron masat ndaj deponive ilegale: Deri në 20.000 euro gjobë dh...



66-vjeçari nga Koçani dorëzoi 18.000 euro për "heqjen" e magjisë së ze...



Acibadem Sistina realizon dy ndërhyrje gjinekologjike robotike brenda një dite



Sistemi "Safe City" shtrihet në Ohër, Kërçovë, Strugë dhe Dibër më 12 tetor



Bekim Sali bojkoton takimin në New York mes Mickoskit dhe presidentit serb...



MPJ konfirmon praninë e delegacionit të Maqedonisë së Veriut në fjalimin e...



Katër persona kallëzohen penalisht për vjedhje të rënda dhe tentativa në...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argëtim

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.